

THE DEMONSTRATIONS OF TETOVO (1968) CONTINUATION OF KOSOVO DEMONSTRATIONS

Fehari Ramadani, Memet Selmani

Abstract

The Tetovo demonstrations of December 1968 were a continuation of those developed in Kosovo a month earlier. They were an expression of dissatisfaction with the policy that the federal state pursued against the Albanian population in the occupied territories. Demonstrators asked for more national rights and equal treatment with other SFRY people, but from local and republican institutions in Tetovo and Macedonia, their demands were classified as chauvinist, separatist, directed against brotherhood-union, state order etc. Neither institution, whether local, republican, or federal, nor any newspaper of the time, discussed about the causes that led to the development of demonstrations. Everywhere demonstrators were accused of being enemies of brotherhood-union and the state.

The aims of this paper are focused on the analysis of the circumstances that led to the protests in December 1968 in Tetovo, although the causes of the 1968 demonstrations were the result of the severe situation in which Albanians lived. Through the development of demonstrations, the aim was to improve the political, economic, cultural situation.

Keywords: *demonstrations, Tetovo, social inequality, Albanians.*

DEMONSTRATAT E TETOVËS (1968) VAZHDIMËSI E DEMONSTRATAVE TË KOSOVËS

Fehari Ramadani, Memet Selmani

Abstrakt

Demonstratat e Tetovës, të dhjetorit 1968, ishin vazhdimësi e atyre të zhvilluara në Kosovë një muaj më parë. Ato ishin shprehje e pakënaqësisë ndaj politikës që shteti federativ ndiqte ndaj popullsisë shqiptare, në territoret e pushtuara.

Demonstruesit kërkonin më shumë të drejta kombëtare dhe trajtim të barabartë me popujt tjerë të RSFJ-së, por nga institucionet lokale dhe republikane në Tetovë dhe Maqedoni, kërkesat e tyre u klasifikuan si: shoviniste, separatiste, se drejtoheshin kundër vëllazërim-bashkimit, rendit shtetëror etj. Asnjëri institucion, qoftë lokal, republikan apo federativ, si dhe asnjë gazetë e kohës nuk diskutoi për shkaqet të cilat çuan në zhvillimin e demonstratave. Gjithkund demonstruesit u akuzuan si armiq të vëllazërim-bashkimit dhe të shtetit.

Qëllimet e këtij punimi janë të përqendruara në analizën e mundshme të rrethanave që sollën në protestën e realizuar në dhjetorin e vitit 1968 në qytetin e Tetovës edhe pse realisht, shkaqet e demonstratave të vitit 1968, ishin rezultat i gjendjes së rëndë në të cilën

jetonin shqiptarët. Nëpërmjet zhvillimit të demonstratave synohej përmirësimi i gjendjes politike, ekonomike, kulturore etj.

Fjalët kyçe: demonstratat, Tetova, pabarazi shoqërore, shqiptarët.

Republika Popullore Federative e Jugosllavisë, e krijuar pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, nuk i zgjidhi çështjet etnike. Ajo trashëgoi nga e kaluara konflikte të thella në marrëdhëniet midis kombeve të ndryshme të këtij shteti shumetnik. Shqiptarët që kishin qenë populli më i diskriminuar në periudhën midis dy luftërave botërore, nën Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene dhe nga viti 1929, nën atë Jugosllave, vazhduan të mbeten në të njëjtën pozitë edhe në shtetin e ri federativ. Mohimi i të drejtave elementare kombëtare të shqiptarëve vazhdoi edhe pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste Jugosllave¹, e cila gjatë periudhës së luftës vazhdimisht kishte propaganduar se pas fitores mbi fashizmin do të ndërtonte një shtet, brenda të cilit do të respektoheshin të drejtat e të gjitha kombeve dhe se do të vendosej barazia midis tyre.

Politika e mohimit të të drejtave kombëtare, e përbuzjes dhe diskriminimit etnik mbi shqiptarët vazhdoi që nga vitet e para të pasluftës. Udhëheqja komuniste jugosllave, territoret e banuara në shumicë nga shqiptarët i ndau në disa njësi të veçanta brenda federatës. Pjesa më e madhe e tyre iu dhanë Kosovës autonome, e cila ishte pjesë e Serbisë federative. Territore të tjera iu bashkuan dy republikave të tjera jugosllave, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Kjo ndarje e territoreve shqiptare në më shumë njësi administrative, kishte për qëllim që t'u pamundësonte shqiptarëve ndonjë organizim kundër sistemit të atëhershëm politik.

Në periudhën në vazhdim, shqiptarët u përballën me një politik aparteidi që ushtrohej nga organet shtetërore. Gjatë periudhës së Rankoviqit*, atyre u mohojë çdo e drejtë kombëtare dhe njerëzore. Ky funksionar i lartë jugosllav, përfaqësues i rrymës radikale serbe, së bashku me bashkëpunëtorët e tij nga UDB-ja*, ushtroi një dhunë të sistematike mbi popullsinë shqiptare, në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi.

Shqiptarët ishin grupi më i madh etnik joslav i RSFJ* dhe jetonin në rajonin më pak të zhvilluar. Krahës problemeve ekonomike, shqiptarët vazhdimisht përballëshin me regjim shtypës dhe mizor. Aparati policor i udhëhequr nga Aleksandar Rankoviq favorizonte popullsinë sllave në rajonet e banuara në shumicë nga shqiptarët².

Megjithatë, në gjysmën e dytë të viteve 60', u duk sikur gjendja e shqiptarëve nën Jugosllavi do të ndryshonte. Këto shpresa buronin nga vendimet e Mbledhjes IV të

¹ Lalaj, Ana. 2000. *Kosova-Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes*. Tiranë: Mësonjëtorja e parë, f. 136.

* Aleksandër Rankoviqi, në periudhën nga nëntori i vitit 1944 deri më 1 korrik të vitit 1966, kishte mbajtur disa funksione të larta në Serbi dhe Jugosllavi, si: nënkryetar i Kuvendit Popullor të Serbisë; shef i OZNA; ministër i Punëve të Brendshme i Federatës; Zëvendëskryeministër i Federatës; Zëvendëspresident i Jugosllavisë etj.

* OZNA (*Odeljenje za zaštitu naroda- Njësi për Mbrojtjen Popullore*), u themelua që gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, më 13 maj 1944. Nga marsi 1946 u quajt UDB (*Uprava državne bezbednosti-Drejtoria e Sigurimit Shtetëror*), kurse nga viti 1966 SDB (*Služba državne bezbednosti-Shërbimi për Sigurim Shtetëror*). Pavarësisht ndryshimit të emërimit, ky institucion ushtroi vazhdimisht dhunë mbi popullsinë shqiptare

* Me Kushtetutën e re të miratuar më 7 prill 1963, Republika Popullore Federative e Jugosllavisë do të quhet Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, me Titon të emëruar president të përhershëm.

² Shih: Lory, Bernard. 2007. *Europa ballkanike nga 1945 në ditët tona*. Tiranë: Dituria, f. 115-116.

Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, e cila u mbajt në Brione*, më 1 korrik të vitit 1966, e që njihet me emrin *Plenumi i Brioneve*. Ajo shënoi një etapë të re në zhvillimin e Jugosllavisë komuniste. Në atë Plenum u mënjanua rryma ultranacionaliste, e udhëhequr nga Aleksandër Rankoviqi, i cili kishte ndjekur një politikë të ashpër antishqiptare dhe triumfoi rryma e udhëhequr nga Josip Broz Tito, i cili përkrahej nga Eduard Kardeli (atë kohë kryetar i Kuvendit Federativ), Vladimir Bakariqi (sekretar i Lidhjes Komuniste të Kroacisë) etj. Rankoviq u akuzua se kishte përgjuar bisedat telefonike të funksionarëve të lartë shtetëror jugosllav, madje edhe të vetë Titos. Pas vendimeve të Brioneve u zvogëlua në një farë mase edhe dhuna dhe terrori shtetëror mbi shqiptarët dhe kjo ngjalli shpresa se e ardhmja do të ishte më e mirë edhe për këtë popull. Për rrjedhojë u rritën kërkesat e shqiptarëve për më shumë të drejta. Për herë të parë “shqiptarët mund ta organizonin jetën e tyre dhe të drejtoheshin të paktën në një pjesë të territoreve të tyre etnike, nga një qendër politike-administrative, nga Prishtina”³.

Pas rënies së Rankoviqit, në Kosovë u shtuan kërkesat për zgjerimin e autonomisë në kuadër të Federatës Jugosllave. Gjatë vitit 1967, u formuan komisione për ndryshimin dhe plotësimin e akteve më të larta politike-juridike në federatë, në republika dhe në krahina autonome. Diskutime kushtetuese u organizuan kudo në Kosovë. Ato udhëhiqeshin nga një Komision i Posaçëm, i cili drejtohej nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Fadil Hoxha. Në këto diskutime u kërkuar që shqiptarët, të njiheshin jo si kombësi por si komb; të lejohej përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe Kosova të shpallej Republikë⁴.

Rritja e kërkesave të shqiptarëve për përmirësimin e pozitës së tyre, në kuadër të shtetit jugosllav, u ndikua jo vetëm nga vendimet e Plenumit të Brioneve, por edhe nga zhvillimet e jashtme. Një faktor i rëndësishëm që ndikoi në këtë drejtim, ishin edhe ngjarjet që u zhvilluan jashtë Jugosllavisë. Në vitin 1968, Evropa u përfshi nga një klimë liberale dhe popujt e bllokut komunist filluan të kërkonin më tepër liri. Bartës të këtyre lëvizjeve ishin studentët, të cilët gjetën mbështetje edhe në shtresat tjera të shoqërisë. Në disa raste edhe një pjesë e strukturave udhëheqëse mbështeti këtë lëvizje⁵. Lëvizje studentore u zhvilluan edhe në Jugosllavi. Nga 3-10 qershor 1968, në masë më të vogël në Beograd dhe më shumë në Zagreb u zhvilluan manifestime studentore. Por, këto veprime kishin më tepër karakter ekonomik⁶.

Diskutimet kushtetuese, Konsulta Gjuhësore e vitit 1967, organizimi i manifestimeve me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në vitin 1968, zhvillimi i lëvizjeve studentore në Evropë, gjatë po atij viti, siç duket qenë faktorë shtytës në luftën e shqiptarëve për realizimin e të drejtave kombëtare⁷. Pas vitesh poshtërimi e diskriminimi nga UDB-ja e Rankoviqit⁸, në vitin 1968, shqiptarët u ngritën në demonstrata për të kërkuar më tepër liri dhe të drejta. Gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1968,

* Brione-ishull në Adriatik, ku Tito shkante për pushime.

³ Krahaso: *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*. 2001. Prizren: Siprint, f. 363; Lalaj, Ana. 2000. *Kosova-Rruga e gjatë...*, f. 138-139; Malcolm, Noel. 2001. *Kosova- Një histori e shkurtër*. Prishtinë-Tiranë: Koha & Shtëpia e Librit. (Botimi i dytë), f. 337; Lory, Bernard, *vep. e përm.*, f. 115.

⁴*Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve...*, f. 363-364.

⁵ Çeku, Ethem. 2009. *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës*. Prishtinë: Dukagjini, f. 13.

⁶ Lory, Bernard, *vep. e përm.*, f. 115.

⁷*Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve...*, f. 364.

⁸ Glenny, Misha. 2007. *Histori e Ballkanit 1804-1999-Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*. Tiranë: Toena, f. 586.

në qytete të ndryshme të Kosovës shpërthyen demonstratat masive, nëpërmjet të cilave kërkohej që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës⁹.

Zhvillimet në Kosovë gjithmonë kanë pasur ndikim edhe në territoret tjera shqiptare jashtë saj. Prishtina ishte Piemonti për shqiptarët nën Jugosllavi. Ajo ishte qendër kulturore, arsimore dhe shpirtërore. Ngjarjet e atjeshme përhapeshin dhe kishin ndikim të fuqishëm edhe në viset tjera shqiptare.

Një muaj pas demonstratave të Kosovës, më 22 dhe 23 dhjetor 1968 edhe shqiptarët e Tetovës e shprehën hapur pakënaqësinë e tyre ndaj politikës shtetërore, e cila në vazhdimësi i kishte trajtuar si qytetarë jo të barabartë. Organizatorë të demonstratës ishin disa të rinj nga Tetova që studionin së bashku me disa studentë nga Kosova në Universitetin e Beogradit dhe në disa Fakultete në Prishtinë, si dhe disa atdhetarë të tjerë nga viset lindore shqiptare¹⁰. Demonstratat e vitit 1968, nxorën në shesh çështjen shqiptare në Jugosllavi, të cilin deri atëherë ishin përpjekur ta mbanin të fshehtë, në mënyra të ndryshme, autoritetet jugosllave¹¹. Ato ishin shprehje e pakënaqësisë kombëtare të shqiptarëve ndaj shtetit i cili u mohonte të drejtat njerëzore dhe politike. Demonstratat shqiptare të fundvitit 1968, si ato në Kosovë ashtu dhe ajo në Tetovë kërkonin avancimin e statusit të kombëtar brenda shtetit shumëkombësh. Kërkesë bazë e tyre ishte trajtim i barabartë i shqiptarëve me kombet tjera të RSFJ-së.

Zhvillimi i demonstratave në Tetovë, shqetësoi udhëheqjen komuniste komunale, republikane dhe federative. Që më 23 dhjetor, u mbajt mbledhje e përbashkët e organizatave shoqërore-politike të komunës së Tetovës, në të cilën demonstratat u vlerësuan si “*armiqësore*”, të cilat kishin për qëllim “*cenimin e vëllazërim-bashkimit*” midis popullit maqedonas dhe atij shqiptar dhe turk, rrënimin e marrëdhënieve “*demokratike e vetëqeverisëse*” dhe kundër politikës së Lidhjes Komuniste. Sipas drejtuesve komunal ngjarjet e Tetovës paraqisnin “*veprimtari armiqësore, të planifikuar dhe organizuar paraprakisht nga ana e një grupi nacionalistësh e shovinistësh*”. Demonstruesit u konsideruan armiq të shtetit, të cilët kishin arritur që të “*mashtrojnë [...] një pjesë të rinisë shkollërore e të tjerë nga kombësia shqiptare*”. Shprehja e pakënaqësisë së shqiptarëve vlerësohej si përpjekje për të dëmtuar marrëdhëniet demokratike e vetëqeverisëse dhe kundër politikës së Lidhjes Komuniste¹². Organet komunale të Tetovës, në vend që të vlerësonin drejt arsyet e zhvillimit të demonstratës, të cilat drejtoheshin kundër pabarazisë dhe mohimit të të drejtave kombëtare të popullsisë shqiptare në Maqedoni dhe Jugosllavi, ata i quanin kërkesat e tyre armiqësore dhe si të rrezikshme për rendin shtetëror.

Se demonstratat e Kosovës patën ndikimin e tyre në Maqedoni, për këtë ishin të vetëdijshëm edhe funksionarët e lartë komunist maqedonas. Sekretari i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë, Angel Çemerski, vlerësonte se “*numri më i madh i ekstremistëve që kanë marrë pjesë në çrregullimet në Tetovë rrjedh prej radhëve të inteligjencies së kombësisë shqiptare*” dhe se “*ekziston lidhja midis ngjarjeve në Tetovë dhe atyre në Kosovë*”¹³.

⁹Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve..., f. 364.

¹⁰ Novosella, Selatin. 2008. *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës, I (Monografi)*. Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, f. 213.

¹¹Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve..., f. 364.

¹² Lita, Qerim. 2018. *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Demonstratat e vitit 1968*.

Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, f. 127-128.

¹³Historia e Popullit Shqiptar IV- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990. Tiranë:

Demonstratat e Tetovës u shqyrtuan edhe në mbledhjen e Komitetit të Qytetit të Konferencës së LKM-së për qytetin e Shkupit, mbajtur më 24 dhjetor 1968. Në atë mbledhje, u konstatua se ngjarjet e Tetovës kishin karakter anti-socialist dhe nacionalist. Në mbledhje u theksua se demonstratat e Tetovës përveç parullave armiqësore dhe shkatërrimit të pronës shtetërore nuk patën ndonjë kërkesë ose ndonjë platformë politike. Nisur nga ky fakt, në mbledhje u vlerësua se demonstratat ishin zhvilluar më tepër për t'u solidarizuar me ato të Prishtinës, të zhvilluara më 28 nëntor, se sa për ndonjë arsye konkrete¹⁴.

Sekretariati i Komitetit Qendror (KQ) të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë (LKM), në mbledhjen e mbajtur me 26 dhjetor 1968 dënoi ashpër demonstratat shqiptare, të cilat i quaji “*armiqësore*”, të drejtuara kundër “*vëllazërim-bashkimit*” dhe kundër integritetit territorial të RSM-së dhe RSFJ-së. Sipas vlerësimeve të Sekretariatit, demonstratat kishin karakter separatist. Prandaj, u kërkuar që udhëheqësit e nacionalizmit dhe të “*veprimtarisë armiqësore*” të luftohen me vendosmëri. Këta veprimtarë, sipas vendimeve të Sekretariatit duhej të dënoheshin dhe të mënjanoreshin nga jeta politiko-shoqërore, pasi sipas drejtuesve komunistë ata përbënin rrezik për realizimin e politikës së LKM-së rreth çështjeve kombëtare, realizimit të barazisë dhe sigurimit të zhvillimit të papenguar të marrëdhënieve socialiste vetëqeverisëse¹⁵.

Të njëjtën ditë u zhvillua mbledhje e zgjeruar e Komitetit Komunal të LKM të Gostivarit, në të cilën u trajtuan demonstratat e Kosovës dhe të Tetovës. Në diskutimet e shumta u vu në dukje se demonstratat ishin zhvilluar në data të rëndësishme shtetërore, siç ishin 29 nëntori dhe 22 dhjetori*, kur institucionet kishin qenë të fokusuar në festimin e këtyre datave të rëndësishme për shtetin shumëkombësh. Mbledhja dënoi veprimet dhe parullat e demonstruesve të Tetovës, si demolimin e objektit të Komitetit Komunal në Tetovë dhe kërkesës së tyre që Prishtina të shndërrohej në qendër drejtuese për shqiptarët. Kjo kërkesë u vlerësua si përpjekje për cenimin e integritetit të RSM. Sipas diskutuesve, Prishtina ishte pjesë e Kosmetit* dhe si e tillë pjesë integrale e Serbisë, prandaj kërkesa u konsiderua armiqësore. Madje, diskutues të tillë, si Vavedin Dervishi u shprehën se ishte e

Toena, f. 363.

¹⁴Lita, Qerim, *vep. e përm.*, f. 129-130.

¹⁵*Po aty*, f. 151-152.

*Më 29 nëntor 1943, në Jajce (Bosnjë dhe Hercegovinë), themelohet Këshilli Antifashist i Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Në atë mbledhje u vendos të themelohej Republika Federative e Jugosllavisë, e cila do të përbëhej nga gjashtë republika, kurse territoret e banuara në shumicë nga shqiptarët do të ndaheshin midis tre republikave jugosllave, duke u pamundësuar të krijonin republikën e tyre. Më 22 dhjetor 1941, në qytetin Rudo (Bosnjë dhe Hercegovinë), themelohet brigada e parë nacionalçlirimtare. Pas formimit të Federatës Jugosllave, kjo datë festohej si dita e themelimit të Armatës Popullore Jugosllave (APJ).

* Kosmet-shkurtesë e Kosovë dhe Metohi. Më 8-10 korrik 1945, në “Kuvendin” e mbledhur në Prizren, ku nga 137 pjesëmarrës vetëm 32 ishin shqiptarë, të cilët vëzhgoheshin nga njerëz të armatosur të Sigurimit Shtetëror Jugosllav, u miratua me duartrokitje, pa votime e nënshkrime, një rezolutë e ardhur e gatshme nga Beogradi. Kështu Rajoni Autonom i Kosovës dhe Metohisë iu bashkua dhunshëm Republikës Popullore të Serbisë. Në prill të vitit 1963, statusi i saj u avancua në krahinë autonome, duke u quajtur Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Në nëntor 1968, do të quhet Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Në viti 1974, me ndryshimet kushtetuese Kosova fitoi statusin e njësisë federale, megjithëse formalisht njihej edhe si pjesë e Serbisë. Në vitet 1989-1990 qeveria serbe dhunshëm ndryshoi Kushtetutën, duke i hequr Kosovës statusin e njësisë federale, e cila më pas u shoqërua me vendosjen e një sistemi aparteidi, i cili mori fund me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1998-1999) dhe ndërhyrjes së forcave të NATO-së (1999).

panevojshme që të diskutohej për të drejtat e pakicave në Maqedoni, pasi sipas tij, pasi të drejtat e tyre ishin avancuar tepër, krahasuar me periudhën e mëparshme¹⁶.

Përdorimi i parullave të tilla, si: “*Rroftë 28 Nëntori*”, “*Rroftë shoku Tito e Fadil Hoxha*”*, “*Poshtë milicia fashiste*” etj., u vlerësuan si shoviniste¹⁷ dhe se ato nënkuptonin kërkesën e demonstruesve për shpëtim të territoreve me shumicë shqiptare nga RSM dhe bashkim me Kosovën.

Më 27 dhjetor, në Tetovë u mbajt mbledhje e jashtëzakonshme e Konferencës Komunale të LKM-Tetovë, në lidhje me demonstratat e 22 dhe 23 dhjetorit. Mbledhjen e kryesoi kryetari i Konferencës Komunale, Xhemali Veseli. Në atë mbledhje morën pjesë edhe funksionarë të tjerë republikan, si: Angel Çermenski, sekretar i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë; Stojan Stojçevski, anëtar i Sekretariatit të KQ të LKM; anëtarët e KQ të LKM: Hixhet Ramadani, i cili ishte edhe nënkryetar i Kuvendit të RSM; Qamuran Tahir, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të RSM etj.

Në fjalën e tij, kryetari i Konferencës Komunale vuri në dukje se demonstratat ishin drejtuar kundër interesit të RSM dhe RSFJ, me qëllim që të dëmtonin unitetin e popullatës shumë-nacionale. Për të argumentuar “*barazinë*” midis popujve që jetonin në Tetovë, ai u përpoq që këtë ta dëshmonte edhe me shifra, si në punësim, poste drejtuese në administratën e komunës, ndarjen e funksioneve republikane për përfaqësuesit nga komuna e Tetovës etj. Megjithatë, shifrat e ofruara nga Xhemali Veseli, dëshmonin të kundërtën e “*barazisë*” së pretenduar prej tij. Ndonëse shqiptarët përbënin mbi 2/3 e popullsisë së Tetovës, papunësia në mesin e tyre ishte shumë e madhe. Nga të dhënat statistikore që posedonte ky funksionar i lartë komunal, në vitin 1967, në Tetovë ishin të punësuar 11.432 vetë, prej të cilëve 6.976 ishin maqedonas, 3.453 shqiptarë dhe 66 turq. Pra, shqiptarët nuk zinin as 1/3 e të punësuarve në komunën ku ata përbënin shumicën absolute të banorëve. Nga 12 vende udhëheqëse në administratën e komunës, 6 u takonin maqedonasve dhe 6 të tjera ishin të ndara midis kombësive, pra as gjysma e tyre nuk ishin shqiptarë. Gjithashtu, nga 26 deputetë nga rajoni i Tetovës, 12 ishin maqedonas dhe 14 të tjerë u takonin kombësive, pra as këta nuk ishin të gjithë shqiptarë. Nga 120 këshilltarë të “*zgjedhur*”, në të dy dhomat e Kuvendit të komunës, 67 ishin maqedonas dhe vetë 53 u takonin kombësive¹⁸.

Në fjalën e tij, kryetari u Konferencës Komunale dënoi hyrjen e demonstruesve në objektin e komunës dhe vendosjen e flamurit shqiptar dhe përdorimin e parullave armiqësore. Përdorimi i parullave “*Tito-Fadil*”, “*Të rrojë Shqipëria*” etj., u vlerësuan si tepër të rrezikshme për bashkëjetesën e grupeve të ndryshme në shtetin shumë-etnik dhe se ato përbënin akt kundër integritetit të RSM-së. Sipas tij, përdorimi i parullës “*Tito-Parti*”, u përdor nga demonstruesit si maskë për të tërhequr në rrugë sa më shumë përkrahës¹⁹ dhe për të fshehur karakterin shovinist të tyre.

Mallko Antevski, në diskutimin e tij jo vetëm që dënoi përdorimin e parullës “*Tito-Fadil*”, por ai propozoi që Fadil Hoxha të mbante një konferencë për shtyp, në të cilën do ta dënonte “*sjelljen e këtyrë*” dhe përdorimin e emrit të tij nga elemente armiqësore, të cilët sipas tij kishin për qëllim të cenonin integritetin e Maqedonisë dhe të mbarë Jugosllavisë. Madje, ai theksoi se demonstruesi që e kishte përdorur parullën “*Rroftë Enver Hoxha*”,

¹⁶Lita, Qerim, *vep. e përm.*, f. 153-158.

*Në atë kohë, Fadil Hoxha ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës.

¹⁷*Po aty*, f. 166.

¹⁸*Po aty*, f. 169-172.

¹⁹*Po aty*, f. 174.

ishte dashur “*aty për aty të vritej*”. Gjithashtu, dënoi ngritjen e flamurit shqiptar në objektin e komunës²⁰.

Hysen Ramadani në fjalën e tij akuzoi funksionarë shqiptarë të Kosovës, se paraqiten si udhëheqës të mbarë popullit shqiptar në Jugosllavi. Këtë veprim ai e quajti fyerje për funksionarët shqiptarë në Maqedoni, pasi sipas tij, drejtuesit e institucioneve shtetërore brenda Maqedonisë, qofshin shqiptarë apo maqedonas, ishin të aftë që vetë t’i zgjidhnin të gjitha problemet që mund të lindnin këtu, pa pas nevojë për ndihmë nga “*jashtë*”²¹.

Demonstratat e cilësuan me karakter shovinist e armiqësor, me qëllime të hapura separatiste²² dhe si të tilla u dënuan ashpër nga pushteti i atëhershëm komunist. Lidhja Komuniste e Maqedonisë, dega e Tetovës, në një Konferencë të mbajtur më 27 dhjetor 1968, duke i dënuar demonstratat si armiqësore, vinte në dukje se në organizimin e tyre kishin qenë të “*përzier edhe elemente jashtë këtij territori*” dhe se qëllimi i demonstratave kishte qenë “*bashkëngjitja e këtyre viseve (territoreve shqiptare lindore-shënimi ynë) me Kosovën dhe krijimin e Shqipërisë së dytë*”²³.

Në fund të mbledhjes, drejtuesi i saj, Xhemali Veseli u quajti demonstratat anti-socialiste, të drejtuara kundër sistemit vetëqeverisës, kundër politikës së Lidhjes Komuniste. Ai kërkoi që institucionet komunale, republikane dhe shtetërore të ishin të vendosura në luftën e tyre për të “*thyer çfarëdolloj shovinizmi*”²⁴.

Në një deklaratë që kryetari i Konferencës Komunale të LKM në Tetovë, Xhemali Veseli kishte dhënë, më 29 dhjetor 1968, Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të RS të Maqedonisë, në lidhje me demonstratat e 22 dhe 23 dhjetorit kishte theksuar se me 22 dhjetor (ditë e diel), në mbrëmje, një grup shqiptarësh, të drejtuar nga Harun Jakupi, Mahmut Abdiu, të dy mjekë nga Tetova dhe Salaudin Huseini dhe Abdulla Kalishta, i kishin kërkuar atij që institucionet të merrnin masa ndaj atyre që kishin grisur flamurin shqiptar, të ngritur në dyqanin e Ismail Spahiut. Pavarësisht se ai u kishte premtuar atyre se institucionet do të merreshin me këtë rast, popullsia e pakënaqur nga ky veprim vazhdoi me demonstratë ditën e nesërme. Më 23 dhjetor (e hënë), si pjesëmarrës në demonstratë ai personalisht kishte arritur të identifikonte punëtorët e arsimit, si: Ibrahim Veliu, Xhevat Vela dhe Ramadan Sinani, që sipas tij kishin ndikuar që demonstrata të merrte karakter më serioz²⁵.

Në mbledhjen e X të Kuvendit të komunës së Tetovës, të mbajtur më 30 dhjetor 1968, ku u shqyrtuan informacionet në lidhje me demonstratat e 22 dhe 23 dhjetorit të vitit 1968. Kuvendi solli vendim që kolektivat punëtoresh dhe shkollat t’i largojnë nga puna të gjithë pjesëmarrësit aktiv të “*demonstratave armiqësore*”, si profesorë, arsimtarë, mësues dhe të tjerë. Ky vendim arsyetohej me faktin se nga mbledhjet e mbajtura të udhëheqësisë politike komunale, të Konferencës komunale të LKM, në mbledhjet e mbajtura të kolektivave punuese të shkollave dhe në mbledhjet tjera të organizatave komunale, si dhe në mbledhjet e mbajtura në organizatat rajonale dhe në fshatra, sipas pjesëmarrësve në mbledhje, “*del qartë se një pjesë e mirë e punëtorëve arsimor kanë marrë pjesë aktive, si në organizimin ashtu dhe në zhvillimin e demonstratave*”. Në mbledhjen X të Kuvendit komunal të Tetovës, u konstatua se “*të gjithë të punësuarit në arsim të cilët kanë marrë pjesë në demonstrata*” edhe më herët ishin marrë me veprimtari nacionaliste-shoviniste dhe se ata

²⁰Po aty, f. 179.

²¹Po aty, f. 187.

²²Државен Архив на Република Македонија- Скопје (Мë tej: ДАРМ). ДАРМ, Бр.1.427.170.12/295-298.

²³ДАРМ.1.427.231.12/89-131.

²⁴Lita, Qerim, *vep. e përm.*, f. 225.

²⁵Po aty, f. 226-227.

ishin të njohur si elementë armiqësor, disa prej të cilëve edhe më herët kanë qenë të dënuar për veprimtari armiqësore²⁶. Gjithashtu, në mbledhjen e mësipërme të Kuvendit komunal të Tetovës, u mor vendimi që të fillonte procedura për marrjen e mandateve të këshilltarëve, që kishin marrë pjesë në demonstratat e 22 dhe 23 dhjetorit të vitit 1968²⁷.

Në një raport të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Maqedonisë theksohej se informimi i gjerë i opinionit nëpërmjet shtypit, radios dhe televizionit kishte ndihmuar “*të hiqej maska e karakterit të demonstratave*”, me çka, sipas raportit “*ishte parë qartë se qëllimi i tyre*” kishte qenë “*sulmi ndaj shoqërisë... socialiste vetëqeverisëse*”, ndaj arritjes së “*vëllazërim-bashkimit ndërmjet maqedonasve, shqiptarëve e turqve*”, ndaj “*integritetit*” të Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe “*integritetit*” të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë²⁸.

Ngjarjet e 22 dhe 23 dhjetorit u pasqyruan edhe në shtypin e kohës, si brenda ashtu edhe jashtë Jugosllavisë. Gazetat që botoheshin brenda shtetit shumëkombësh, si: “*Borba*”, “*Политика*” (*Politika*), “*Oslobođenje*” (*Oslobogjenje*), “*Rilindja*”, “*Vjesnik*”, “*Delo*” etj., publikuan lajmin se në Tetovë ishin zhvilluar demonstrata “*të iniciuara nga një grup ekstrem*”. Disa prej tyre lajmin e përcollën duke u bazuar në informatat që ofronte Agjencia Telegrafike Jugosllave (TANJUG), dhe disa të tjera sipas korrespondentëve të tyre. E përbashkëta e shkrimeve, të gazetave të mësipërme, të datës 24 dhjetor, ishte se ato i paraqisnin demonstruesit si njerëz të dhunshëm, të cilët kishin thyer vitrinat e lokaleve, se kishin thyer xhamat e veturave, se ishin futur në zyrat e organizatave politiko-shoqërore, ku kishin thyer xhamat e tyre dhe se në dritaret e objekteve zyrtare kishin ngritur flamurin shqiptar etj. Gjithashtu njoftohej se organet e rendit publik kishin marrë masa për normalizimin e gjendjes dhe se kishte pasur të lënduar²⁹.

Në shkrimet e datës 25 dhjetor, jepeshin informacione më të zgjeruara për ngjarjet në Tetovë. Kështu, gazeta e Beogradit “*Politika*”, në shkrimin e korrespondentit të saj, J. Popovski, me titull “*Demonstrata pa kërkesa*”, jepte një informacion të zgjeruar për aktivitetin e organizatave politike në Tetovë, pas zhvillimit të demonstratave. Në mbledhjet e kolektiveve punuese, sipas artikullit në fjalë, ishin dënuar demonstratat dhe ishte kërkuar marrja e “*masave më të rrepta kundër pjesëmarrësve e organizatorëve*” të tyre. Në artikull theksohej se për “*faktorët më relevant në Tetovë*”, njeriu që kishte ngritur flamurin shqiptar si dhe “*pjesëmarrësit më provokues në demonstratë*” ishin të njohur që më herët si armiq të popullit. Bazuar në burimet që ofronin organizatat politike në Tetovë, gazeta theksonte se “*shovinistët shqiptarë*”, ishin goditur rëndë nga injorimi që u kishin bërë atyre “*njerëzit serioz të kombësisë shqiptare e turke*” të cilët “*qëndruan anash demonstratave*”, si edhe nga fakti se maqedonasit e kishin ruajtur gjakftohtësinë. Sipas artikullit, demonstruesit, kishin brohoritur parulla armiqësore dhe se nuk kishin parashtruar kërkesa që të zgjidhet “*ky apo ai problem i kombësisë shqiptare*”. Sipas gazetës “*Politika*” edhe parulla e vetme “*Tito-Fadil*” që ishte përdorur nga demonstruesit, ishte armiqësore. Artikullshkruesi, Popovski, nëpërmjet kësaj parulle shihte dëshirën e demonstruesve për “*bashkëngjitjen e këtij territori të Maqedonisë* (territoreve të banuara me shumicë nga shqiptarët –shënimi ynë) *me Kosovën*”³⁰. Këtë “*dëshirë*” të demonstruesve Popovski e shihte tek brohoritja e emrit të Fadil Hoxhës, i cili në atë kohë ishte funksionar i lartë në Kosovë dhe sipas tij, kjo

²⁶ ДАРМ). Собрание на општина Тетово, Х-та заедничка седница, Бр. 06-7490/1-30.XII.1968 г. Тетово.

²⁷ ДАРМ. Собрание на општина Тетово, Х-та заедничка седница, Бр. 06-7492/1-30.XII.1968 г. Тетово.

²⁸ ДАРМ.1.427.170.12/272-280. Shkup, janar 1969.

²⁹ ДАРМ.1.427.231.12/89-131.

³⁰ ДАРМ.1.427.231.12/89-131.

nënkuptonte dëshirën e demonstruesve për t'i bashkangjitur territoret shqiptare në Maqedoni me Kosovën.

Shqiptarëve jo vetëm që u ishte mohuar e drejta për të jetuar brenda kufijve të shtetit të tyre, si dhe e drejta për të pasur republikën e tyre, ashtu siç u ishte lejuar popujve të tjerë të Jugosllavisë, por, atyre nuk u lejohej të jetonin, brenda kufijve të shtetit pushtues në të njëjtën njësi administrative, me Kosovën. Prandaj, të kërkoje të jetoje brenda të njëjtës njësi administrative me bashkëkombësit e tu ishte e papranueshme dhe armiqësore për pushtetin e atëhershëm jugosllav.

Korrespondenti i gazetës “Politika”, Popovski, arrinte në konstatimin se demonstruesit nuk kishin parashtruar kërkesa “*për realizimin e ndonjë parimi kushtetues për barazinë dhe zhvillimin shoqëror*”, sepse probleme të tilla, sipas tij, realisht as që ekzistonin. Konstatimin e tij, Popovski e mbështeste në deklaratat e disa funksionarëve të atëhershëm shqiptarë, sipas të cilëve shqiptarët gëzonin të gjitha të drejtat që u takonin dhe për rrjedhojë nuk kishin se çka të kërkonin një këtë drejtim. Ai citonte fjalët e një funksionari të atëhershëm shqiptar, i cili ndër të tjera kishte bërë fjalë “*për arritjet e mëdha të realizuara në fushën e ekonomisë, kulturës dhe të barazisë së plotë të kombësive në tërësi*”. Artikullshkruesi, theksonte se mossa e suksesit më i madh për demonstruesit ishte “*fakti se ato nuk gjetën mbështetje te popullsia e fshatrave, edhe pse në të gjitha fshatrat dërguan misionar të tyre me qëllim që ta ftojnë fshatarësinë që t’ju bashkëngjitet*”. Mosardhja e fshatarëve në Tetovë, ditët e demonstratave dëshmonte, sipas Popovskit, se rrethina e Tetovës kishte “*standarde dhe kushte të mira*”. Sipas korrespondentit në fjalë “*thua se asnjë komunë në Jugosllavi nuk kishte rrjet rrugor të asfaltuar nëpër fshatra ashtu siç ishte rasti me Tetovën*”. Ai shton se numri i madh i fshatrave ishin të elektrifikuar, se nuk kishte fshat pa shkollë, se ekzistonin rreth 600 punëtorë të arsimit vetëm nga mjediset e kombësive* dhe thujse në tërësi ishte vendosur administrata dygjuhësore³¹.

Në përfundim të shkrimit të tij, Popovski arrinte në konstatimin se demonstratat e Tetovës ishin vepër e “*shovinistëve të tërbuar të kombësisë shqiptare*”, të cilët kishin për qëllim të “*cenonin vëllazërim-bashkimin*” e ndërtuar me shumë mund. Por, sipas tij, demonstruesit nuk ia kishin arritur qëllimit, pasi ato ishin dënuar jo vetëm nga maqedonasit, por, edhe nga vetë popullsia shqiptare dhe ajo turke³². Në asnjë rast ai nuk e paraqiti gjendjen reale të popullsisë shqiptare në Tetovë e në Maqedoni. Shqiptarët jo vetëm që nuk trajtoheshin si qytetarë të barabartë me maqedonasit, por atyre u mohoheshin edhe të drejtat njerëzore. Ata diskriminoheshin në punësim, arsim, avancim në institucionet lokale dhe shtetërore etj.

Ashtu si edhe në vendet tjera komuniste, ku mediumet ishin nën kontrollin e rreptë të shtetit, ashtu edhe në RSFJ, të gjitha lajmet i nënshtroheshin kontrollit të hollësishëm nga organet shtetërore. Asgjë nuk mund të publikohej, nëse nuk përputhej me politikën shtetërore. Nën ndikimin e kësaj politike edhe gazeta “*Rilindja*” e Prishtinës, në shkrimin e saj të 24 dhjetorit njoftonte për demonstratat e Tetovës, për të cilët theksonte se ishin organizuar nga elementë reaksionarë dhe shovinistë, të kombësisë shqiptare. Sipas “*Rilindjes*”, demonstruesit kishin demoluar vitrinat e lokaleve dhe kishin shkakuar dëme të tjera materiale. Gjithashtu njoftohej se gjatë zhvillimit të demonstratave ishin plagosur pesë persona prej të cilëve, dy ishin policë³³.

* Nocioni **kombësi**, që kishte kuptimin e pakicës kombëtare, përdorej në Jugosllavi për të gjithë popujt jugosllavë të Federatës, ku bënin pjesë edhe shqiptarët.

³¹ДАРМ.1.427.231.12/89-131.

³²Po aty.

³³Po aty.

Në shkrimin e 25 dhjetorit, “*Rilindja*”, u kushtonte një artikull demonstratave të Tetovës. Sipas kësaj gazete, qëllimi i demonstratave kishte qenë “*cënimi i vëllazërim-bashkimit*” dhe se demonstruesit kishin brohoritur parulla shoviniste. Demonstruesit kishin sulmuar ndërtesën e Bankës Komerciale, ku ndodheshin zyrat e Komitetit Komunal të LKM dhe të organizatave të tjera politiko-shoqërore të qytetit. Një grup i vogël demonstruesish ishin ngjitur në katin e tretë të objektit në fjalë, ku ndodheshin zyrat e Komitetit Komunal të LKM dhe kishin thyer dyert dhe dritaret³⁴.

Në një artikull të 27 dhjetorit të vitit 1968, “*Rilindja*” shkruante se demonstratat ishin dënuar në mbarë Republikën e Maqedonisë dhe ishin etiketuar si përpjekje për rrënimin shoqërisë socialiste vetëqeverisëse. Sipas gazetës në fjalë “*karakteri armiqësor e shovinist i demonstratave*” në Tetovë, të cilat ishin “*organizuar nga elementet nacionaliste të kombësisë shqiptare, me qëllime të hapura nacionaliste*”, ishin dënuar nga “*populli punonjës*”, në Tetovë dhe në mbarë Republikën. Sipas “*Rilindjes*”, në një mbledhje të kolektivit punues të Shkollës Filllore “*Liria*”, në Tetovë, të mbajtur më 26 dhjetor, ishte vendosur që t’u ndërpritet “*marrëdhënia e rregullt e punës dy punonjësve të arsimit për shkak të pjesëmarrjes në eksese shoviniste në Tetovë*”. Në tubimin e punonjësve të kësaj shkolle ishte theksuar se për “*armiq të bashkësisë sonë nuk ka vend në kolektivin*” e tyre. Gjithashtu, edhe Qendra Mjekësore në Tetovë dhe Bashkësia Fetare Islame, dega e Tetovës, i kishin dënuar demonstratat dhe shprehnin mbështetjen e tyre për qëndrimin e organizatave politiko-shoqërore në Tetovë³⁵.

Gazeta e Sarajevës “*Oslobođenje*”, në shkrimin me titull: “*Dënimi i demonstratave në Tetovë*”, përveç tjerash jepte reagimet e të punësuarve në kombinatin “*Todor Cipovski Merxhan*”, në Tetovë. Sipas kësaj gazete, të punësuarit e këtij kombinati, pa dallim të përkatësisë kombëtare, njëzëri i dënonin demonstratat e zhvilluara në Tetovë dhe i quanin ato si “*sulm mbi interesat e vetëqeverisjes..., revolucionit socialist..., vëllazërim-bashkimit midis maqedonasve, shqiptarëve, turqve e të tjerëve*”.

Në një shkrim tjetër të “*Oslobođenje*”, që i takon fundit të dhjetorit, me titull, “**Drejtuesit e komunitetit mysliman i dënojnë demonstratat**”, ndër të tjera theksohej se krerët e komunitetit myslimanë në Tetovë dhe rrethinë i kanë dënuar ashpër demonstratat dhe se i kanë dhënë mbështetje të plotë qëndrimit të aktivitetit politik të komunës së Tetovës. Sipas gazetës, drejtuesit fetarë i cilësonin demonstratat antishqiptare, pasi sipas tyre ato orientoheshin “*kundër interesave historike të shqiptarëve..., të arriturave të revolucionit... dhe kundër vëllazërim-bashkimit të kombeve dhe kombësive jugosllave*”³⁶.

Gazeta “*Vjesnik*” e Zagrebit, në një shkrim të sajën, të datës 29 dhjetor 1968, duke u mbështetur në vlerësimet e organeve shtetërore, demonstratat e Tetovës i cilësonte si sulm të ashpër kundër përpjekjeve të bashkësisë socialiste për “*afirmimin e plotë të të drejtave vetëqeverisëse të kombeve e kombësive tona*”. Korrespondenti, R. Çiçak, njoftonte se Këshilli Ekzekutiv kishte kërkuar nga organizatat e Lidhjes Socialiste që t’i luftonin hapur dhe pa kompromis, në mjediset e tyre nacionale, “*çdo shfaqje të tendencave nacionaliste*”³⁷.

³⁴Po aty.

³⁵Po aty.

³⁶Po aty.

³⁷Po aty.

Pjesëmarrësit e demonstratave në Republikën Socialiste të Maqedonisë u dënuan për vepër penale kundër shtetit dhe kundër tyre u organizuan 13 gjykime. Në to u gjykuan gjithsej 170 shqiptarë³⁸.

R e z y m e

Demonstratat e Tetovës, të 22 dhe 23 dhjetorit 1968, ishin vazhdimësi e demonstratave të zhvilluara në Kosovë një muaj më parë. Ato ishin shprehje e pakënaqësisë ndaj trajtimit që shteti i bënte këtij grupi etnik, të cilin e kishte ndarë në 3-4 njësi brenda Federatës Jugosllave. Njëkohësisht ato ishin edhe solidarizim me demonstratat e Kosovës, pasi Prishtina gjithmonë ka qenë qendër orientuese për shqiptarët e mbetur nën Jugosllavi.

Nëpërmjet zhvillimit të demonstratave shqiptarët synonin të fitonin më shumë të drejta brenda RSFJ-së, por institucionet lokale dhe republikane në Tetovë dhe Maqedoni, në vend se të merreshin me kërkesat reale të shqiptarëve, ata i quajtën ato të nxitura nga jashtë, se kishin karakter shovinist, separatist, se drejtoheshin kundër vëllazërim-bashkimit e rendit shtetëror etj.

Gjithashtu, të gjitha organet e shtypit, pavarësisht vendit ku ato botoheshin, duke iu përmbajtur politikës zyrtare, patën qasje të njëjtë ndaj demonstratave të Tetovës dhe në përgjithësi ndaj kërkesave të popullit shqiptar. Demonstratat u cilësuan si armiqësore, kurse organizatorët e tyre u cilësuan si njerëz të rrezikshëm, të cilët edhe më herët kishin vepruar kundër interesave të shtetit, se ata bashkëpunonin me njerëz nga jashtë Maqedonisë.

Asnjëra gazetë dhe asnjëri institucion nuk e paraqiste gjendjen e vërtetë në të cilën ndodheshin shqiptarët nën Jugosllavi. Në shkrimet dhe diskutimet e tyre, gazetat jugosllave dhe funksionarët lokal e republikan, bënin fjalë për vëllazërim-bashkimin, standardin e lartë të jetesës, të drejtat e avancuara e kështu me radhë. Por, realisht shqiptarët ishin populli më i diskriminuar. Po të marrim shembull vetëm Tetovën e fundviteve 60^{te}, të shekullit të kaluar do të shohim se edhe pse shqiptarët përbënin pjesën dërrmuese të popullsisë, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të pushtetit për të rritur artificialisht numrin e popullsisë maqedonase dhe turke, në dëm të shqiptarëve, prapëseprapë një pakicë fare e vogël e shqiptarëve ishin të punësuar. Krejt ndryshe ishte gjendja e maqedonasve dhe të tjerëve.

Asnjë gazetë dhe asnjë institucion komunal e republikan, në shkrimet dhe diskutimet e tyre mbi demonstratat e Tetovës, nuk bënte fjalë për arsyet e vërteta të pakënaqësisë së popullsisë shqiptare. Përfshirja e shqiptarëve në administratën shtetërore përbënte një pakicë të papërfillshme, si në Tetovë ashtu edhe në qytetet tjera ku ata ishin popullsi shumicë. Askund nuk përmendeshin faktet se gjatë gjithë periudhës së pasluftës, mbi shqiptarët ishte ushtruar dhunë sistematike; ishin organizuar procese të montuara politike; shqiptarëve u ishte mohuar e drejta e përdorimit të flamurit kombëtar etj. Askund nuk thuhet qoftë edhe një fjalë se shqiptarët kishin mbetur pjesë e Jugosllavisë së Titos, jashtë vullnetit të tyre. Shqiptarët edhe pse për nga numri zinin vendin e tretë në shtetin shumëkombësh komunist, ata quheshin kombësi, kurse gjashtë popujt sllavë njiheshin si kombe. Shqiptarëve nuk u ishte lejuar të jetonin as brenda një njësie të vetme shtetformuese në Jugosllavi, por ishin ndarë midis serbëve, malazezëve dhe maqedonëve.

³⁸*Historia e Popullit Shqiptar IV- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*. Tiranë: Toena, f. 363.

Shkaqet e demonstratave të vitit 1968, ishin rezultat i gjendjes së rëndë në të cilën jetonin shqiptarët. Nëpërmjet zhvillimit të demonstratave synohej përmirësimi i gjendjes politike, ekonomike, kulturore etj.

Burimet dhe literatura:

Dokumente arkivore:

Државен Архив на Република Македонија- Скопје.

Dokumente të publikuara:

Lita, Qerim. 2018. *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Demonstratat e vitit 1968*. Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A;

Literatura:

Çeku, Ethem. 2009. *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës*. Prishtinë: Dukagjini;

Glenny, Misha. 2007. *Histori e Ballkanit 1804-1999-Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*. Tiranë: Toena;

Historia e Popullit Shqiptar IV- Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990. Tiranë: Toena;

Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve. 2001. Prizren: Siprint;

Lalaj, Ana. 2000. *Kosova-Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes*. Tiranë: Mësonjëtorja e parë;

Lory, Bernard. 2007. *Europa ballkanike nga 1945 në ditët tona*. Tiranë: Dituria;

Malcolm, Noel. 2001. *Kosova- Një histori e shkurtër*. Prishtinë-Tiranë: Koha & Shtëpia e Librit. (Botimi i dytë);

Novosella, Selatin. 2008. *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës, I (Monografi)*. Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës.